



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike

Nr. 1162/6Prot.

Tiranë, më 30.03.2017

V E N D I M

Nr 23 Datë 30.03.2017

PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR
NË SH.A “PORTI DETAR” SHËNGJIN
MBI “ZBATIMIN E PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË
DHE VLERËSIMIN E AKTIVITETIT EKONOMIKO-FINANCIARE”

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 15, 25 dhe 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë dhe vlerësimin të aktivitetit ekonomiko-financiare”, të ushtruar në subjektin “SH.A Porti Detar” Shëngjin për periudhën 01.01.2014 deri 31.12.2016.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi:

Në 4 raste, nga auditimi i kryer mbi zbatimin e punimeve civile sipas kontratave të kontraktuara (Rehabilitimi i hyrjes në portin e Shëngjinit; Shtrimi i pjesës së mbetur të

sipërfaqes së portit, faza 1; Rikonstrukcion i objektit për terminalin e pasagjerëve; Vendosja e Shinave në kalatën e re), u konstatua që investimet për ndërtimet dhe rikonstrukcionet e realizuara në SH.A “Porti Detar” Shëngjin, nga ana e Autoritetit Kontraktor nuk është aplikuar për leje ndërtimi, në kundërshtim me Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”.

Për këtë rekomandojmë:

Nga Autoriteti Kontraktor të analizohet përgjegjësia e kryerjes së investimeve pa leje ndërtimi, dhe në vazhdimësi të mos procedohet me fillimin e punimeve pa u pajisur paraprakisht me leje ndërtimi.

Në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi:

Në 4 raste mbi zbatimin e kontratave të shërbimeve me objekt: “Blerje uniforma për sektorin e Sigurisë dhe të Zjarrefiksës të Portit Shëngjin”; “Rilevim topografik e batimetri e basenit të Portit Shëngjin”; “Projekti e preventivi i thellimit të kalatës së re dhe të basenit të portit Shëngjin”; “ Blerje karburanti 2014 dhe 2015” u konstatua se, nuk janë hartuar procesverbale të marrjes në dorëzim të mallit sipas kontratës dhe kërkesave të VKM Nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” kreu VIII, pika 2/b : “Për t’u siguruar nëse cilësia e mallrave është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës ose lëvrimet, Autoriteti kontraktor, ... mban procesverbal, me shkrim. Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës” dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik” si dhe të UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Pika 42 “Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues”, Pika 54 “Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore.... financat duhet të kontrollojnë nëse fletëhyrja ka bashkëlidhur dokumentacionin justifikues që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës”, (trajtuar më hollësisht në faqen 49-109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- Në zbatimin e punimeve të ndërtimit për kontratën me objekt “Thellimi i kalates së re dhe basenit të Portit Detar, faza IV” u konstatua se ngritja e grupit të kolaudit është bërë rreth 2 (dy) muaj me vonesë në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Neni 12 ku thuhet se “Emërimi i kolaudatorit apo grupit të kolaudit... brenda 30 ditëve nga përfundimit i punimeve të ndërtimit” .

Për këtë rekomandojmë:

- Të merren masa, nga “Porti Detar” Shëngjin, që në zbatim të kontratave për mallra të ngrihet komisioni me specialistë të fushës dhe të rregullohet procesi i marrjes në dorëzim të mallrave, si dhe të ngrejë grupin e kolaudit të punimeve brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të punimeve të ndërtimit të deklaruar nga zbatuesi i punimeve.

3. Gjetje nga auditimi:

Referuar raportit të ekspertëve kontabël për pasqyrat financiare të vitit 2015, u konstatuan parregullsitë e mëposhtme:

- Llogaritë e të drejtave ndaj tatimeve, të pasqyruara në bilanc, për TVSH-në dhe Tatim Fitimin nuk rakordojnë me sistemin informatik.

- Shuma e kapitalit aksionar të paraqitur në pasqyrat financiare nuk përputhet me gjendjen e kapitalit aksionar të paraqitur në ekstraktin e QKR të bizneseve. Në pasqyrat financiare kapitali është 656,924,000 lekë ndërsa në QKR është 632,906,000 lekë, ndryshimet vijnë si rezultat i mosdepozitimit të ndryshimeve të kapitalit në QKR, po kështu nuk është depozituar vendimi për emërimin e ekspertëve kontabël për auditimin e pasqyrave financiare 2015.

- Sipas Udhëzimit Nr. 6 datë 31.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” subvencionet e marra të shoqërisë nga buxheti i shtetit për investimet e bëra në port, janë brenda fushës së zbatimit të TVSH-së, dhe duhen bërë rregullime në vlerën e TVSH-së të këtyre investimeve.

- Nuk ka analizë për llogarinë diferenca rivlerësimi në shumën 2,399,872 lekë. Gjatë ushtrimit për vitin 2015 është bërë rivlerësimi i aseteve të shoqërisë duke krijuar një diferencë të re rivlerësimi në shumën 698,590,217 lekë, e cila nuk ka marrë në konsideratë diferencën e krijuar nga rivlerësimi i parë.

- Shoqëria ka mbetur në nivelin e mëparshëm të llogaritjes së provizioneve për klientët mbi një vit me një vlerë neto prej 711,011 lekë. Gjithashtu në këtë grup të aktivitetit, ka edhe debitorë të tjerë mbi një vit në vlerën 1,170,943 lekë, pra shuma e të dyja këtyre llogarive prej 1,881,954 lekë përfaqëson detyrime të vjetra për të cilat nuk është bërë rishikim i tyre me propozime konkrete për ndjekjen dhe sistemimin përfundimtar të tyre.

Për sa më sipër Porti Detar Sh.A Shëngjin nuk ka marrë masa për shqyrtimin, koordinimin apo rregullimin e konstatimeve të ekspertëve kontabël duke e lënë situatën të pandryshuar. Për pasojë, problematikat e shfaqura, me shumë mundësi do të shfaqen edhe në pasqyrat financiare të vitit 2016.

Për këtë rekomandojmë:

Titullari i Portit Detar, Shëngjin dhe Sektori i Financës, të analizojnë parregullsitë e evidentuara në raportin e ekspertëve kontabël për pasqyrat financiare të vitit 2015, duke nxjerrë përfundime mbi arsyen e ekzistencës së këtyre problematikave dhe parandalimin e tyre në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

4. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se Porti Detar Sh.A Shëngjin nuk ka analizuar situatën e debitorëve, dhe nuk ka nxjerrë përfundime për zgjidhjen e situatave të ndryshme. Nuk ka një koordinim për sa i përket rregullshmërisë së procedurave që duhet të ndiqen për arkëtimin e këtyre vlerave, pasi debi të ndryshme me vonesë të njëjtë, kanë stade të ndryshme të procedurës së ndjekur për t’i arkëtuar. Për një pjesë të detyrimeve, ndonëse vlera të vogla, nuk është marrë asnjë masë.

Për këtë rekomandojmë:

Nga Titullari i Portit Detar Shëngjin, Sektori i Financës dhe Juristit i shoqërisë, të analizohet situata e debitorëve, nga ku të dalin përfundime për zgjidhjen e situatave të ndryshme të krijuara, dhe të hartohet një procedurë standarte për arkëtimin e detyrimeve të debitorëve deri në adresimin në organet gjyqësore nëse do të jetë e nevojshme, pavarësisht nga vlera.

Menjëherë dhe në vazhdim

5. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i praktikave të ndjekura nga institucioni për inventarizimin vjetor të aseteve të shoqërisë u konstatua se nga grupet e punës nuk është hartuar asnjë raport përmbledhës mbi përfundimin e inventarizimit, veprim ky në kundërshtim me Pikën 85/c të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” ku thuhet se: “Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues”.

Për këtë rekomandojmë:

Në vazhdimësi t’i kushtohet vëmendje maksimale inventarizimit vjetor të aseteve të shoqërisë, si një nga mjetet kryesore për dhënien e një sigurie të arsyeshme të mbrojtjes së pasurisë fizike të institucionit, duke zbatuar me rigorozitet rregullat për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik.

Në vazhdimësi

6. Gjetje nga auditimi:

U konstatuan raste të marrjes së shërbimeve ose mallrave pa kryer procedurë prokurimi dhe konkretisht Porti Detar Sh.A Shëngjin ka marrë shërbimin e telefonisë dhe internetit nga operatori [REDACTED], me vlerë totale 661,095 lekë për vitet 2014-2016, si dhe ka kryer pagesën prej 72,800 lekë në datën 05.04.2016 për faturën nr. 6, datë 30.03.2016 për bileta udhëtimi. Këto dy raste janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pasi për këto shërbime duhet të ishte zhvilluar procedurë prokurimi.

Për këtë rekomandojmë:

Porti Detar Sh.A Shëngjin, të marrë masa që në vazhdimësi të ndërpritet rruga e sigurimit të mallrave dhe shërbimeve jashtë procedurave të prokurimit publik, për të cilat tregu ofron më shumë se një operator ekonomik, si një garanci për përdorimin me ekonomikitet, efektivitet dhe efijencë të fondeve të shoqërisë.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi:

Për procedurën blerje e vogël me urdhër prokurimi nr. 17 datë 20.08.2014 me objekt “Riparim diferenciali piruni” është konstatuar se:

Specifikimet teknike të kërkuara për këtë procedurë si afati prej 24 orësh dhe afërsia gjeografike e operatorit ekonomik me autoritetin kontraktor, janë kritere diskriminuese, duke ulur kështu mundësinë e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik. Ky veprim është në kundërshtim me VKM 914 datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kjo ka sjellë që në procedurë të marrë pjesë vetëm një operator ekonomik. Duke marrë në konsideratë faktin se urdhri i prokurimit ka dalë në datën 20.08.2014 dhe procedura është zhvilluar në datën 27.08.2014 (7 ditë më vonë), hedh poshtë prezumimin se ky shërbim, me këto specifikime, është zhvilluar në kushtet e emergjencës.

Për këtë rekomandojmë:

Në vazhdimësi komisioni për blerjet e vogla të tregojë kujdes të veçantë në përcaktimin e specifikimeve teknike, duke shmangur kritere diskriminuese, në mënyrë që të nxitet pjesëmarrje sa më e madhe e operatorëve ekonomik, me qëllim përdorimin me ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet të fondeve publike.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i praktikave të konsumit të karburantit, u konstatua se:

Me Vendimin Nr. 3, datë 11.02.2015, Këshilli Mbikqyrës ka miratuar normativë për sa i përket furnizimit me karburant për zjarrfiksen, mjetet në dispozicion të portit, si dhe për sektorin e sigurisë. Por nga auditimi u konstatua se Porti Detar Sh.A Shëngjin nuk ka kryer asnjë procedurë, test, apo kryer analizën historike të konsumit, duke paraqitur normativë të pajustificuar për vendim në Këshillin Mbikqyrës. *Për pasojë vendimi i marrë nga Këshilli Mbikqyrës, nuk i ka dhënë një zgjidhje të arsyeshme rregullshmerisë së konsumit të karburantit.*

Për këtë rekomandojmë:

-Titullari i Portit Detar Sh.A Shëngjin të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për testimin e normës së harxhimit të makinerive të portit, si dhe të hartojë një procedurë për testimin periodik të këtyre makinerive, në mënyrë që llogaritja e konsumit të karburantit të jetë sa më objektive.

-Këshilli Mbikqyrës të rishikojë Vendimin Nr. 3, datë 11.02.2015 për përcaktimin e normave fikse për përdorimin e karburantit, duke u bazuar tek testet e bëra nga Porti Detar Sh.A Shëngjin.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi:

-Shoqëria nuk ka miratuar nivelin e pagave nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në kundërshtim me Ligjin Nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, Neni 6, Pika 1, Shkronja a, ku citohet se: Organet kolegjiale drejtuese të njësive të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare, me kapital mbi 50 % shtetëror,

miratojnë: a) nivelet e pagave të punonjësve të tyre, brenda kufirit minimal e maksimal të caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive të tyre financiare dhe pas miratimit nga ministri përkatës.

Për këtë rekomandojmë:

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Titullari i “Porti Detar Shëngjin” SH.A, të merren masa për miratimin e nivelit të pagave nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në zbatim të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”.

Në vazhdimësi

10. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi rezulton se, në rregulloren e brendshme dhe në strukturën e miratuar të institucionit, nuk është përcaktuar lloji i arsimimit për të gjitha pozicionet e punës. Gjithashtu nuk janë të përcaktuar qartë përshkrimi i punës për çdo pozicion, duke sjell mos identifikimin e detyrave dhe të drejtave që ka çdo punonjës i shoqërisë. Në rregulloren e brendshme janë përcaktuar vetëm funksionet apo detyrat e çdo drejtorie dhe jo përshkrimi i punës për çdo pozicion pune. Nuk ka procedura të qarta lidhur me marrjen në punë të punonjësve, konkurrimin dhe vlerësimin e kandidatëve.

Për këtë rekomandojmë:

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Shoqërisë, të rihartohet rregullorja e përcaktimit të kriterëve të punësimit, sipas pozicionit të vendeve të punës dhe të merren masa për zbatimin korrekt në rekrutimin apo lëvizjen e punonjësve.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi:

Për periudhën e audituar (2014-2016), nga shoqëria i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për 66 punonjës, si dhe janë punësuar 65 punonjës të rinj. Si rezultat i zgjidhjes të kontratës së punësimit duke mos ndjekur procedurat ligjore në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, deri më datë 31.12.2016, kjo shoqëri është palë (e paditur) në 2 çështje gjyqësore në lidhje me marrëdhëniet e punës, e cila fazën e parë të gjykimit e ka humbur. Vlera e kërkuar nga këto dy punonjës është **2,830,430 lekë**, me një efekt financiar negativ të pritshëm me pasojë rëndim kosto për “Porti Detar Shëngjin” SH.A.

Për këtë rekomandojmë:

Titullari i Portit Detar Shëngjin dhe sektori Financës, të analizojnë me saktësi numrin e fuqisë punëtore aktuale dhe të harmonizojë atë me nevojën aktuale dhe perspektivën e organizimit dhe funksionimit të Shoqërisë, duke marrë në kohë masat e nevojshme organizative, proceduriale dhe ligjore në këtë drejtim.

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të analizohen në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimin e detyrimeve të shtuara gjyqësore, duke evidentuar përgjegjësitë individuale, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi në lidhje me procedurat e përgatitjes së dosjeve për dhënien me qira, u konstatua se ka mangësi në procedurën e dhënies me qira dhe në dokumentacionin e paraqitur nga subjekte e interesuara. Për miratimin e kontratave të qirasë, Shoqëria Porti Detar Sh.A Shëngjin, është mjaftuar vetëm me një kërkesë të paraqitur nga subjekti për marrjen me qira, në kundërshtim me VKM Nr. 54, datë 5.2.2014, Kapitulli II, Pika 1 dhe 7 të këtij vendimi.

Për këtë rekomandojmë:

Nga Sektori i Financave, juristi i shoqërisë si dhe nga drejtuesit e shoqërisë të hartohen kriteret për dhënien me qira të aseteve të shoqërisë dhe të kualifikohen dhe pranohen ato kërkesa për marrje me qira, të cilat plotësojnë kushtet sipas legjislacionit në fuqi.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i përfundimit të rregjistrimit të aseteve të shoqërisë pranë ZVRPP Lezhë u konstatua se; në rregjistrat hipotekorë shoqëria “Porti Detar Shëngjin” SH.A ka të pa evidentuar dhe rregjistruar një sipërfaqe prej 8,703 m² truall funksional të transferuar me VKM Nr. 586 datë 10.09.2004.

Për këtë rekomandojmë:

Nga sektori i financës dhe juristi, të merren të gjitha masat e nevojshme për përfundimin e identifikimit dhe regjistrimit të aseteve në ZVRPP Lezhë dhe vënien në shfrytëzim të tyre për interesat e shoqërisë.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se për vitet 2014 dhe 2015, punonjësit e “Porti Detar Shëngjin” SH.A kanë përfituar një shpërblim mbi pagë që kap **vlerën e 3,420,000 lekë, vlerë e cila përbën efekt financiar negativ për shoqërinë.** Ky shpërblim për punonjësit e “Porti Detar Shëngjin” SH.A është përfituar nga vendimet e Këshillit Mbikëqyrës Nr.12, datë 22.12.2014 në shumën 1,510,000 lekë dhe Nr.10, datë 02.12.2015 në shumën 1,910,000 lekë, para daljes së rezultatit financiar vjetor pozitiv. Këto vendime janë në kundërshtim me Ligjin Nr.10405, datë 24.03.2011 “*Për kompetencat për caktimin e pagave*”.

Për këtë rekomandojmë:

*Këshilli Mbikëqyrës dhe Titullari i shoqërisë “Porti Detar Shëngjin” SH.A, të marrin masa që të rishqyrtojnë shpërblimin e dhënë për punonjësit e Shoqërisë për vitet 2014 dhe 2015 në vlerën e **3,420,000 lekë**, shpërblime të dhëna para daljes së rezultatit financiar vjetor pozitiv, si dhe të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës për vlerën e mësipërme, e cila përbën efekt financiar negativ për Buxhetin e shoqërisë.*

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i kontratës për operimin e tragetit në linjën Shëngjin-Brindisi lidhur midis shoqërisë “Porti Detar Shëngjin” Sh.A dhe kompanisë private “.....” u konstatua një penalitet i pa mbajtur ndaj kësaj kompanie private në vlerën prej **20,000 euro, vlerë e cila përbën efekt financiarë negativ** për shoqërinë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Këshilli Mbikëqyrës dhe Titullari i shoqërisë “Porti Detar Shëngjin” SH.A, të marrin masa që të rishqyrtojnë vlerën prej 20,000 euro, si dhe të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës për vlerën e mësipërme, e cila përbën efekt financiar negativ për Buxhetin e shoqërisë.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i praktikave me Bankën u konstatua se: Në datën 29.06.2015 në, është bërë pagesa prej 91,664 lekë, në zbatim të vendimit nr. prot. 44/9, nr. rregj. 39 datë 12.06.2015 të nxjerrë nga shoqëria përmbarimore “.....”, si pasojë e detyrimit të papaguar të punonjësve të Portit Detar Sh.A Shëngjin ndaj operatorit telefonik Për sa më sipër, mosveprimi për mbajtjen e këtyre detyrimeve ndaj punonjësve përpara së çështja të kalonte në përmbarim, ka sjellë një rritje të vlerës së paguar nga Porti Detar Sh.A Shëngjin me **20,600 lekë, vlerë e cila përbën efekt financiar negative.**

Për sa më sipër rekomandojmë:

Këshilli Mbikëqyrës dhe Titullari i shoqërisë “Porti Detar Shëngjin” SH.A, të marrin masa që të rishqyrtojnë vlerën prej 20,600 lekë, si dhe të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës për vlerën e mësipërme, e cila përbën efekt financiar negativ për Buxhetin e shoqërisë.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi:

Për procedurën blerje me vlerë të vogël, me Urdhër Prokurimi Nr. 1, datë 18.01.2016 me objekt “.....” është konstatuar se fatura tatimore e lëshuar nga subjekti daton më 17.12.2015 dhe pagesa për mallin e kërkuar, është kryer në datën 18.12.2015. Ndërkohë urdhëri i prokurimi është nxjerrë në datën 18.01.2016. Pra, fillimisht është kryer pagesa kundrejt operatorit ekonomik më datë 18.12.2015 dhe më datë 18.01.2016 është nxjerrë urdhëri për prokurimin, pas të cilit janë kryer fiktivisht procedurat për prokurime nën vlerën 100,000 lekë, duke u marrë tre oferta dhe duke u shpallur fitues operatori i paracaktuar dhe i parapaguar nga “.....” Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe Udhëzimin Nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”.

Për këtë rekomandojmë:

Titullari i Portit Detar Sh.A Shëngjin, në vazhdimësi të trajtojë me kujdes rastet e emergjencës për të shmangur veprimet e sforcuara që sjellin shkelje të dispozitave ligjore.

Deri më datë 30.06.2017

18. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i kryer mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm i KLSH, dërguar me shkresën nr. 1004/7, datë 31.12.2012, rezultoi se janë zbatuar pjesërisht në masën 90% rekomandimet e dhëna nga KLSH:

Nga 17 masa organizative, janë realizuar 11 masa plotësisht, 5 masa janë në proces zbatimi dhe 1 masë nuk është zbatuar. Është realizuar pjesërisht 1 masë për shpërblim dëmi në shumën 314,244 lekë, ndërsa shuma e mbetur **343,224 lekë** është në proces realizimi.

Për këtë rekomandojmë:

Porti Detar Shëngjin, të marrë masat për zbatimin e plotë të rekomandimeve të parealizuara nga auditimi i mëparshëm i KLSH, me qëllim realizimin e plotë të masës shpërblim dëmi në shumën 343,224 lekë.

Deri më datë 31.06.2017

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i detajuar i konsumit të karburantit u konstatua se përdorimi i 18,300 litrave karburant (nga të cilat 5360 për vitin 2014, 7860 litra për vitin 2015 dhe 5080 litra për vitin 2016) nga stafi i Portit Detar Sh.A Shëngjin është i pajustificuar, në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Gjithashtu u konstatua se për largësi lëvizjeje apo shërbime të njëjta, nga punonjësit janë tërhequr sasi të ndryshme karburanti. Pra nuk ka njësi matjeje, normë të caktuar për lëvizjet e punonjësve, apo ndonjë logjikë të përdorur mbi akordimin e sasive të karburantit. Vlera totale e karburantit të konsumuar pa justifikimet dhe dokumentacionin përkatës për tre vitet objekt auditimi, e llogaritur duke përdorur çmimin e hyrjes në magazinë, është **3,066,314 lekë**, vlerë e cila **përbën dëm ekonomik** për Portin Detar Sh.A Shëngjin.

Për këtë rekomandojmë:

*Titullari i Portit Detar Sh.A Shëngjin, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për analizimin e përgjegjësive dhe përcaktimin e përfituesve të sasisë prej 18,300 litra karburant në tre vitet objekt auditimi, si dhe të kërkohet në rrugë administrative bazuar në Kodin e Procedurave Administrative, shpërblimi i dëmit në shumën **3,066,314 lekë**, vlerë e cila është përdorur në formën e tollonave të karburantit.*

Deri më datë 30.06.2017

2. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **“Rehabilitimi i hyrjes në portin e Shëngjinit”** u konstatua se është financuar kontraktori **“.....” sh.p.k.**, për zëra punimesh të pakryera, për diferenca në zëra dhe volume, duke përfituar padrejtësisht për punë të pakryer në **shumën 2,248,994 lekë, duke shkaktuar një dëm ekonomik** për buxhetin e shoqërisë “Porti Detar” Shëngjin.

Për këtë rekomandojmë:

Porti Detar Shëngjin, të marrë masa, që t’i kërkojë kontraktorit “.....” sh.p.k., duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 2,248,994 lekë, të cilën e ka përfituar tepër për punime të pakryera.

Deri më datë 30.06.2017

3. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **“Shtrimi i Pjesës së Mbetur të Sipërfaqes së Portit, Faza e I”** u konstatua se është financuar kontraktori **“.....” sh.p.k.**, për zëra punimesh të pakryera, për diferenca në zëra dhe volume duke përfituar padrejtësisht për punë të pakryer në **shumën 1,448,800 lekë, duke shkaktuar një dëm ekonomik** për buxhetin e shoqërisë “Porti Detar” SH.A Shëngjin.

Për këtë rekomandojmë:

Porti Detar Shëngjin, të marrë masa, që t’i kërkojë kontraktorit “.....” sh.p.k., duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 1,448,800 lekë, të cilën e ka përfituar tepër për punime të pakryera.

Deri më datë 30.06.2017

4. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit të zhvilluar me objekt **“Sistemi CCTV në Portin e Shëngjinit, Faza I”**, viti 2016, u konstatua përfitim i padrejtë nga bashkimi i operatorëve ekonomik **“.....” sh.p.k & “.....” sh.p.k** shpk në vlerën **1,237,560 lekë , vlerë e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë** “Porti Detar Shëngjin” SH.A.

Për këtë rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 1,237,560 lekë, nga bashkimi i operatorëve ekonomik “.....” sh.p.k & “.....” sh.p.k, për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt objekt “Sistemi CCTV në Portin e Shëngjinit, Faza I”, viti 2016.

Deri më datë 30.06.2017

5. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit të zhvilluar me objekt **“Shtrimi i pjesës së mbetur të sipërfaqes së portit, faza 1”** për vitin 2015, u konstatua kualifikimi i gabuar

nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe shpallja fitues nga ana e Autoritetit Kontraktor e operatorit ekonomik “.....” sh.p.k dhe s’kualifikimi i gabuar i operatorit ekonomik “.....” sh.p.k me një diferencë në ofertën e ofruar prej **798,720 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë “Porti Detar Shëngjin” SH.A.**

Për këtë rekomandojmë:

Këshilli Mbikqyrës të shqyrtojë vlerën 798,720 lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit “Shtrimi i pjesës së mbetur të sipërfaqes së portit, faza 1”, vlerë e cila ka dalë si rezultat i diferencës së ofertës së shpallur fituese, operatori Ekonomik “.....” sh.p.k., me vlerë të ofertës 2,721,000 lekë pa TVSH, me ofertën e operatorit ekonomik “.....” shpk, e cila është skualifikuar pa të drejt me vlerë 2,055,400 lekë pa TVSH.

Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse për vlerën 798,720 lekë, vlerë e cila për shoqërinë “Porti Detar Shëngjin” SH.A përbën dëm ekonomik.

Deri më datë 30.06.2017

6. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit në tenderin me objekt **“Blerje gjeneratori dhe aksesore plotësues”** Autoriteti Kontraktor ka shpallur fitues Operatorin ekonomik “.....” sh.p.k, me Fond Limit 3,329,050 lekë pa TVSH dhe u konstatua se: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në procesin e kualifikim/s’kualifikimit të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në tender, ka vepruar në kundërshtim me DST, duke kualifikuar në mënyrë të padrejtë OE “.....” sh.p.k dhe duke s’kualifikuar po në mënyrë të padrejtë OE “.....” sh.p.k.

Për operatorin ekonomik “.....” shpk u konstatua se nuk i ka përmbushur kërkesat e kërkuara nga autoriteti kontraktor, dhe nuk duhej të ishte shpallur fitues.

Nga auditimi i dokumentacionit të Operatorit ekonomik “.....” shpk, u konstatua se plotëson të gjitha kërkesat e kërkuara nga AK.

Për sa më sipër grupi i auditimit del në përfundimin se operatori ekonomik “.....” shpk është s’kualifikuar në mënyrë të padrejtë, dhe diferenca ndërmjet operatorit ekonomik “.....” shpk, i cili është shpallur fitues dhe ofertës së operatorit ekonomik “.....” shpk, (3,600,420 lekë me TVSH - 2,868,000 lekë me TVSH) = **732,420 lekë përbën dëm ekonomik për shoqërinë.**

Për këtë rekomandojmë:

*Drejtori i Portit Detar Shëngjin, të marrë masa, që t’i kërkojë anëtarëve të KVO-së, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **732,420 lekë**, si dëm ekonomik i shkaktuar.*

Deri më datë 30.06.2017

7. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me **“Rikonstruksioni i Objektivit për Terminalin e Pasagjerëve, Shëngjin”** u konstatua se është financuar kontraktori “.....” sh.p.k., për zëra punimesh të pakryera, për diferenca në zëra dhe volume duke

përfitur padrejtësisht për punë të pakryer në **shumën 505,300 lekë, duke shkaktuar një dëm ekonomik** për buxhetin e shoqërisë “Porti Detar” SH.A Shëngjin.

Për këtë rekomandojmë:

Porti Detar Shëngjin, të marrë masa, që t’i kërkojë kontraktorit “.....” sh.p.k., duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 505,300 lekë, të cilën e ka përfitur tepër për punime të pakryera.

Deri më datë 30.06.2017

8. Gjetje nga auditimi:

Në zbatimin e kontratës së shërbimit me objekt **“Blerje uniforma për sektorin e Sigurisë dhe të Zjarrëfikses të Portit Shëngjin”** të nënshkruar në datën 12.03.2014 ndërmjet Autoritetit Kontraktor SH.A “Porti Detar” Shëngjin dhe Kontraktorit **“.....” sh.p.k.**, u konstatua se: Likuidimi në vlerën 1,018,200 leke me TVSH është lëvruar në kundërshtim me nenin 28 (likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar) të Kontratës Nr. 2, datë 12.03.2014, ku thuhet se **“Dëmet e likuidueshme për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore: a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25 % të vlerës së kontratës”**.

Lëvrimi total sipas kontratës, neni 4, do të realizohet brenda 20 (njëzetë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës, duke iu referuar grafikut të lëvrimin... pra lëvrimi total është realizuar në datën 07.04.2014 dhe jo sipas afatit siç parashikohet në kontratë. Materialet (Veshjet) janë shitur, duke shkelur kushtet e kontratës dy palëshe. Lëvrimi me vonesë i uniformave për sektorin e sigurisë dhe të zjarrfikëses, është bërë në kundërshtim me nenin 4 dhe 28 të kontratës të nënshkruar. Për dorëzimin e vonuar të uniformave, **dëmi llogaritet në vlerën 230,792 lekë** dhe ngarkon me përgjegjësi shoqërinë **“.....” sh.p.k.**

Përsa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa nga Porti Detar Shëngjin, që t’i kërkojë kontraktorit “ L” sh.p.k. duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 230,792 lekë.

Deri më datë 30.06.2017

9. Gjetje nga auditimi:

Për periudhën e audituar është konstatuar se nga Porti Detar Sh.A Shëngjin janë paguar gjoba në vlerën totale prej **207,069 lekë**, për arsye vonesash në deklarime, lëshim fature tatimore të pasaktë, mosdhënie informacioni, etj. Këto gjoba të paguara nga të ardhurat e Portit Detar Sh.A Shëngjin, grupi i auditimit i vlerëson si përgjegjësi individuale, ndërkohë nga drejtimi nuk është marrë asnjë masë për caktimin e përgjegjësive dhe për arkëtimin e këtyre gjobave nga personat përgjegjës. **Vlera 207,069 përbën dëm ekonomik për Portin Detar Sh.A Shëngjin.**

Për këtë rekomandojmë:

Titullari i shoqërisë të marrë masa për ngritjen e një grup pune për përcaktimin e përgjegjësive individuale për gjobat e paguara nga të ardhurat e Portit Detar Sh.A Shëngjin, si dhe të kërkohet në rrugë administrative arkëtimi i shumës 207,069 lekë, nga personat përgjegjës për shkaktimin e tij.

Deri më datë 30.06.2017

10. Gjetje nga auditimi:

Në zbatimin e kontratës së shërbimit me objekt **“Rilevim topografik e batimetri e basenit të Portit Shëngjin”** nënshkruar më datë 18.02.2014 ndërmjet Autoritetit Kontraktor SH.A “Porti Detar” Shëngjin dhe Kontraktorit “.....” **sh.p.k.**, me vlerë 1,302,000 lekë pa TVSH, u konstatua se:

Nga krahasimi i hartës së rilevimit topografik e batimetrik (shkalla 1:1000) të realizuar nga shoqëria “.....” sh.p.k me hartën (Plan vendosje në shkallë 1:4000) të miratuar nga titullari i portit detar (hartë e cila është hedhur në sistem elektronik të APP) rezulton se nuk janë realizuar 30 Ha rilevim (nga ku, 24.4 ha për batimetri dhe 5.6 ha për rilevim topografik) por janë realizuar 28 Ha (nga ku, 24.4 ha për batimetri dhe 3.6 ha për rilevim topografik). Pra sa më sipër, rilevimi topografik nuk është bërë sipas kufirit të rilevimit të portit të përcaktuar në hartën e miratuar nga Autoriteti Kontrktor dhe si pasojë janë situacionuar më tepër 2 ha rilevim topografik, duke përfutuar në mënyrë të padrejtë më tepër për punë të pakryer vlerën **104,160 lekë**.

Përsa më sipër rekomandojmë:

*Të merren masa nga Porti Detar Shëngjin, që t’i kërkojë kontraktorit “.....” sh.p.k. duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **104,160 lekë**, të përfutuar tepër në mënyrë të padrejtë.*

Deri më datë 30.06.2017

11. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit të zhvilluar me objekt **“Blerje karburanti naftë D1 (eurodiesel) për vitin 2016”**, u konstatua kualifikimi i gabuar nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe shpallja fitues nga ana e Autoritetit Kontraktorë e operatorit ekonomik “.....” SHA dhe s’kualifikimi i gabuar i operatorit ekonomik “.....” SH.A me një diferencë në marzhin e fitimit prej 4.6 % duke i shkaktuar buxhetit të shoqërisë “Porti Detar Shëngjin” SH.A një dëm ekonomik prej **76,666 lekë**, e cila ka dalë si rezultat i diferencës së marzhit të fitimit prej 4.6 % të ofruar nga shoqërisa e shpallur fituese “.....” SHA (13.8 %) me operatorin ekonomik “.....” SH.A (9.2%).

Për këtë rekomandojmë:

*Këshilli Mbikëqyrës të marrë masa për ngritjen e një grup pune për përcaktimin e përgjegjësive individuale, si dhe të kërkohet në rrugë administrative arkëtimi i shumës për vlerën **76,666 lekë**, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë “Porti Detar Shëngjin” SH.A.*

Deri më datë 30.06.2017

12. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me “Vendosja e Shinave në Kalatën e Re” u konstatua se është financuar kontraktori “.....” sh.p.k., për zëra punimesh të pakryera, për diferenca në zëra dhe volume duke përfituar padrejtësisht për punë të pakryer në **shumën 30,000 lekë, duke shkaktuar një dëm ekonomik** për buxhetin e shoqërisë “Porti Detar” SH.A Shëngjin.

Për këtë rekomandojmë:

Porti Detar Shëngjin, të marrë masa, që t’i kërkojë kontraktorit “.....” sh.p.k., duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 30,000 lekë, të cilën e ka përfituar tepër për punime të pakryera.

Deri me datë 30.06.2017

13. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i praktikave me Bankën u konstatua se: Në datën 29.06.2015 në “.....” është bërë pagesa prej 91,664 lekë, në zbatim të vendimit nr. prot. 44/9, nr. rregj. 39 datë 12.06.2015 të nxjerrë nga shoqëria përmbarimore “.....”, si pasojë e detyrimit të papaguar të punonjësve të Portit Detar Sh.A Shëngjin ndaj operatorit telefonik Nga kjo, vlera 20,600 lekë përfaqson shpezimet operative të shoqërisë përmbarimore dhe detyrimi neto i punonjësve është 71,064 lekë. Deri në momentin e auditimit janë arkëtuar 68,277 lekë. Diferenca ndërmjet detyrimit të punonjësve të paraqitur nga përmbarimi dhe e paguar nga shoqëria, me vlerën e arkëtuar nga vetë punonjësit (71,064-68,277) prej **2,787 lekë përbën dëm ekonomik** për Portin Detar Sh.A Shëngjin.

Për këtë rekomandojmë:

Drejtori i Portit Detar Shëngjin, të marrë masa, që t’i kërkojë personave përgjegjës, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 2,787 lekë, si dëm ekonomik i shkaktuar nga moskryerja e pagesave të shërbimit telefonik.

Deri më datë 30.06.2017

C1. TË ARDHURA TË MUNGUARA, NGA DETYRIME KONTRAKTUALE.

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i vjeljes së të ardhurave nga procesi i ngarkim/shkarkimit si dhe i tarifave portuale u konstatua të ardhura të pa arkëtuara nga përpunimi i anijeve, si dhe nga mos arkëtimi i tarifave portuale në shumën prej **9,831,854 lekë** nga ngarkim shkarkimi, **14,889 euro** dhe **255 USD** nga tarifatat portuale si dhe (6,320,918 -5,609,907 provizionuar) = **711,011 lekë** e mbartur, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për shoqërinë.

Për këtë rekomandojmë:

Titullari i shoqërisë, sektori i financës si dhe juristi të ndjekin të gjitha procedurat e nevojshme administrative si dhe të kërkohet në rrugë ligjore, arkëtimi i vlerës prej 9,831,854 lekë nga ngarkim shkarkimi, 14,889 euro dhe 255 USD nga tarifatat portuale si

dhe shumën 711,011 lekë e mbartur, nga debitorët deri në sekuestro të pasurive të tyre. Gjithashtu në të ardhmen të kryhet sistemimi i vlerës në pasqyrat financiare në klasat përkatëse të llogarive për të reduktuar barrën tatimore të vitit fiskal.

Në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi:

- Nga verifikimi i kontratave të qirave në periudhën objekt auditimi rezultoi se në “Porti Detar Shëngjin” SH.A në këtë periudhë rezultojnë 2 kontrata të lidhura me subjekte private. Referuar dokumentacionit nga zyra e Financës detyrimi i akumuluar për këto dy kontrata qiraje pranë shoqërisë deri më 31.02.2016 është **108,000 lek, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara.**

- Sipërfaqet e asetëve të zëna pa lidhur kontratë qiraje për periudhën objekt auditimit kapin një vlerë prej **750,000 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për shoqërinë.**

Për sa më sipër rekomandojmë:

Titullari i shoqërisë, sektori i financës si dhe juristi të ndjekin të gjitha procedurat e nevojshme administrative si dhe të kërkohet në rrugë ligjore, arkëtimi i vlerës 858,000 lekë, nga qiramarrësit debitorë.

Në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të kontratave të qirave në periudhën objekt auditimi në “Portin Detar Shëngjin” rezultojnë 4 kontrata të lidhura me subjekte private dhe individë për kontrata ankorimi mjete lundruese në kalatën me tarifat sipas vendimit të Këshillit Mbikqyrës. Referuar dokumentacionit nga zyra e Financës, detyrimi i akumuluar për këto kontrata qiraje deri më 31.02.2016 është **3,850 euro, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për shoqërinë.**

Për sa më sipër rekomandojmë:

Titullari i shoqërisë, sektori i financës si dhe juristi të ndjekin të gjitha procedurat e nevojshme administrative si dhe të kërkohet në rrugë ligjore, arkëtimi i vlerës 3,850 euro, nga qiramarrësit debitorë.

Në vazhdimësi

C2. MASA PËR PËRDORIMIN PA EFEKTIVITET TË FONDEVE.

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i dokumentacionit në dosje si dhe në sistemin elektronik të APP-së mbi zbatimin e procedurave të tenderit me objekt **“Blerje uniforma për sektorin e Sigurisë dhe të Zjarrfikses të Portit Shëngjin”** me Urdhër Prokurimi Nr. 14, datë 10.02.2014, pa TVSH u konstatua se:

Dokumenti i paraqitur për kontratën e ngjashme nga operatori ekonomik “**.....**” sh.p.k, i formës marrëveshje për projektin e marrjes së pajisjeve për pastrim e Bashkisë së “**.....**” midis “Agjencisë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim” dhe shoqërisë

“.....” sh.p.k., është në kundërshtim me Kriterin e Veçantë (kapaciteti ekonomik, pika 1, 2 dhe 3) të DST sepse:

- Nuk kemi të bëjmë me kontratë të ngjashme të së njëjtës natyrë, por me një marrëveshje.
- Kjo marrëveshje nuk është e lidhur me Autoritete Kontraktore.
- Shoqëria nuk ka kontratë të shoqëruar me fatura tatimore shitje.
- Operatori ekonomik nuk ka paraqitur fotografi apo katalogë të mostrave të materialeve që kërkohen.

Për sa më sipër, kualifikimi nga KVO në mënyrë të padrejtë i operatorin ekonomik “.....” sh.p.k., me mangësi në përmbushjen e kërkesave të kualifikimit të përcaktuara në DST, për procedurën *“Blerje uniforme për sektorin e Sigurisë dhe të Zjarrfikses të Portit Shëngjin”* me vlerë 848,500 lekë pa TVSH rezulton shpenzim me impakt negative për shoqërinë, veprim ky në kundërshtim me VKM Nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V, Pika 4 (Hapja dhe vlerësimi i ofertave).

Për këtë rekomandojmë:

Autoriteti Kontraktor, SH.A “Porti Detar” Shëngjin, të bëjë një analizë të kujdesshme të vlerave dhe të çdo kriteri të vendosur, në menyrë që të garantojë cilësinë e mallrave dhe shërbimeve të ofruar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i dokumentacionit në dosje si dhe ai elektronik në sistemin elektronik të APP mbi zbatimin e procedurave të tenderit me objekt *“Rilevim topografik e batimetri e basenit të Portit Shëngjin” me Urdhër Prokurimi Nr. 08, datë 16.01.2014, me fond limit 1,386,000 lekë pa TVSH u konstatua se:*

- Dokumenti i paraqitur për kontratën e ngjashme nga “.....” sh.p.k., është një kontratë shërbimi e lidhur ndërmjet firmës “.....” sh.p.k, Tiranë dhe firmës “.....” sh.p.k., me objekt *“Punime topografike dhe batimetrike e projektit të zbatimit për H/C-et “.....”, rrethi “.....” dokument i cili është në kundërshtim me Kriterin e veçantë (kapaciteti ekonomik) të DST.*

- Shoqëria “.....” sh.p.k., në zbatim të kërkesave të veçanta të DST pika 2, ka paraqitur Dëshminë e aftësisë së lundrimit për mjete të vogla, por për mjetet për realizimin e batimetrisë, operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumente pronësie ose kontratë qeraje të shoqëruar me dokumente pronësie.

Sa më sipër, KVO ka kualifikuar në mënyrë të padrejtë operatorin ekonomik “.....” sh.p.k., e cila nuk ka përmbushur kërkesat e kualifikimit të përcaktuara në DST, veprim ky në kundërshtim me VKM Nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V, Pika 4 (Hapja dhe vlerësimi i ofertave) dhe ngarkon me përgjegjësi komisionin e vlerësimit të ofertave.

Për këtë rekomandojmë:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në vazhdimësi, të realizojë procesin e vlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomike, duke gjykuar me korrektësi mbi plotësimin e kushteve

të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikim/s'kualifikimit të dekomencionit tekniko-ligjorë të dokumenteve të tenderit në menyrë që të garantojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dhe të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Menjëherë dhe në vazhdim

3. Gjetje nga auditimi:

- Në 48 praktika të procedurave të prokurimit me vlera të vogla, të kryera gjatë periudhës së auditimit, me vlerë totale 6,938,982 lekë, u konstatua se nga KVO nuk është kryer asnjë analizë për përcaktimin e fondit limit. Nuk ka asnjë shkresë që të vërtetojë se është testuar tregu. Në disa raste është përmendur se fondi limit është bazuar në eksperiencat e mëparshme, por për këtë nuk ka asnjë shkresë bashkangjitur apo ndonjë fletë hyrje magazine për ta vërtetuar. Ky veprim është në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, si dhe me Udhëzimin Nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”.

- Në 39 praktika të procedurave të prokurimit me vlera të vogla, të kryera gjatë periudhës së auditimit, me vlerë totale 6,299,610 lekë, është konstatuar mungesa e procesverbalit të marrjes në dorëzim për mallrat e prokuruar në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” dhe Udhëzimin Nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”.

- Në 3 praktika të procedurave me vlera të vogla është konstatuar mungesa e një procesverbali të raportit përmbledhës në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”.

Për këtë rekomandojmë:

Porti Detar Sh.A Shëngjin, të marrë masa që në vazhdimësi t'i kushtojë vëmendje maksimale:

- *Përcaktimit të fondit limit për blerjet me vlera të vogla, si një nga parakushtet për dhënien e sigurisë së arsyeshme për përdorimin me ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet të fondeve, duke argumentuar dhe dokumentuar vlerat e përcaktuara, në përputhje me udhëzimet për procedurat me vlera të vogla.*

- *Marrjes në dorëzim të mallrave të prokuruar, si një dokument dhe një veprim vërtetues se këto procedura kanë përfunduar me sukses, dhe se mallrat e përfituara janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.*

Menjëherë dhe në vazhdimësi

4. Gjetje nga auditimi:

- Për procedurën blerje e vogël me Urdhër Prokurimi Nr. 16, datë 25.07.2014 me objekt “Sigurimi i aseteve të Portit Detar Sh.A Shëngjin” është konstatuar se operatori “.....” i shpallur fitues nuk i ka përmbushur kërkesat e autoritetit kontraktor, dhe duhet të ishte skualifikuar. Ky veprim është në kundërshtim me VKM 914 datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- Për procedurën blerje e vogël me urdhër prokurimi nr. 11 datë 18.04.2015 me objekt “Ndërtim i faqes së internetit” u konstatua se:

Për këtë shërbim të prokuruar nuk ka asnjë specifikim teknik, në kundërshtim me VKM 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe Udhëzimin nr. 2 datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, duke e lënë totalisht evazive marrjen e ofertave si dhe marrjen e shërbimit.

- Për dy procedurat blerje me Urdhër Prokurimi Nr. 15, datë 21.05.2015 me objekt “Karroca, lopata, doreza etj” me vlerë 116,250 lekë dhe blerje me Urdhër Prokurimi Nr. 14, datë 20.05.2015 me objekt “Tub, puseta, tel, rrjetë” me vlerë 119,800 lekë konstatohet se janë prokuruar mallra të ngjashme, dhe janë trajtuar në dy procedura të ndryshme brenda dy ditëve, duke e copëzuar fondin. Ky veprim bie në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, pasi këto procedura duhet të ishin trajtuar si një e vetme, duke u pasqyruar në faqen elektronike të APP si procedurë e prokurimit për blerje me vlera të vogla duke rritur konkurrencën për përfitimin e një vlere sa më ekonomike për Portin Detar Sh.A Shëngjin, dhe jo si dy procedura nën vlerën 100,000 lekë.

Për këtë rekomandojmë:

Titullari i Portit Detar, Shëngjin, nisur nga problematikat e shpeshta të hasura në procedurat e blerjeve me vlera të vogla, të marrë masa për trajnimin e stafit që angazhohet në njësi prokurimi apo komisione të vlerësimit të ofertave, me qëllim përmirësimin profesional të tyre në fushën e prokurimeve, duke përfituar kështu procedura të sakta, transparente dhe në përputhje me ligjin dhe rregullat për prokurimet publike.

Në vazhdimësi

D. MASA DISIPLINORE.

I. Bazuar e në referim të nenit nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Drejtori i Portit Detar Sh.a. Shëngjin të analizojë përgjegjësinë dhe t’i propozojë Këshillit Mbikëqyrës masën disiplinore nga “Vërejtje me paralajmërim” deri në “Zgjidhje të Kontratës së punës”, sipas shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit për:

1. Zoti B.V me detyrë Zv/Drejtor, sepse:

- Në cilësinë e anëtarit të KVO për blerjet e vogla për periudhën 10.01.2014-23.05.2014 nuk ka kryer asnjë analizë për përcaktimin e fondit limit dhe nuk ka hartuar procesverbal të marrjes në dorëzim për mallrat e prokuruar, në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 2 datë 28.03.2013 dhe Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” si dhe me VKM 914 datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

II. Bazuar e në referim të nenit nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, si dhe kontratës kolektive të punës nr. 6 datë 18.05.2016 neni 15, Drejtori i Portit Detar Shëngjin të analizojë përgjegjësinë dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Zgjidhje të kontratës së punës”, sipas shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit për:

1. Zoti A.P me detyrë Përgjegjës ofiçine, sepse:

- Në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për procedurën me Urdhër prokurimi nr. 15, datë 06.06.2016 me objekt “Blerje vinçi”, nuk ka argumentuar në mënyrë të saktë përlllogaritjen e fondin limit, në kundërshtim me VKM Nr. 914 datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- Në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për procedurën me Urdhër prokurimi nr. 04, datë 26.02.2016 me objekt “Blerje gjeneratori dhe aksesore plotësues”, nuk ka justifikuar përzgjedhjen e procedurës së përdorur dhe nuk ka argumentuar përzgjedhjen e operatorëve ekonomik të ftuar në kundërshtim me nenin 33, pika 2 dhe neni 39 pika 4, të VKM 914 datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

- Në cilësinë e anëtarit të KVO për blerjet e vogla për periudhën 2014-2016, nuk ka argumentuar llogaritjen e fondit limit, nuk ka hartuar procesverbal të marrjes në dorëzim për mallrat e prokuruar, për kualifikim të padrejtë në tenderin “Sigurimi i aseteve të Portit Detar Sh.A Shëngjin” pa plotësuar kriteret, për vendosje kritere të pa drejta në tenderin “Riparim diferenciali piruni”, për mos vendosje të specifikimeve teknike në tenderin “Ndërtim i faqes së internetit”, për kryerje fiktive të tenderit “Tavolinë karrige zyre”, për copëzim fondi për dy procedurat me urdhër prokurimi nr. 15 datë 21.05.2015 dhe nr. 14 datë 20.05.2015. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 2 datë 28.03.2013 dhe Udhëzimin Nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” si dhe me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- Në cilësinë e personit të autorizuar për shqyrtimin e ankesave në procedurën e prokurimit me objekt “Shtrimi i pjesës së mbetur të sipërfaqes së portit, faza 1” për vitin 2015, i cili nëpërmjet raport rekomandimit të hartuar prej tij, ka dhënë opinion dizinformues për titullarin e autoritetit kontraktorë duke e orientuar atë drejtë një vendimarrje të gabuar, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 ‘Për prokurimin publik’ dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu X neni 78 pika 6(a).

2. Znj. T.N me detyrë Përgjegjëse e zyrës së prokurimeve, sepse:

- Në cilësinë e anëtarit të KVO, për procedurën me Urdhër Prokurimi Nr. 15, datë 06.06.2016 me objekt “Blerje vinçi”, ka kualifikuar në mënyrë të gabuar operatorin ekonomik “.....” shpk” në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- Në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën me Urdhër prokurimi 04, datë 26.02.2016 me objekt “Blerje gjeneratori dhe aksesore plotësues” ka skualifikuar në mënyrë të padrejtë operatorin ekonomik “.....” shpk dhe ka kualifikuar pa të drejtë operatorin ekonomik “.....” shpk duke shkaktuar një dëm ekonomik prej 732,420 lekë për portin dhe buxhetin e shtetit, në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe Udhëzimin Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Në cilësinë e anëtarit të KVO, për procedurën me Urdhër prokurimi nr. 51, datë 23.05.2015 me objekt “Shtrimi i pjesës së mbetur të sipërfaqes së portit, faza 1”, ka kualifikuar në mënyrë të gabuar operatorin ekonomik “.....” shpk në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar neni 53 pika 4 si dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

3. Zoti E.D me detyrë Përgjegjës i zyrës së marketingut, sepse:

- Në cilësinë e anëtarit të KVO, për procedurën me Urdhër Prokurimi Nr. 15, datë 06.06.2016 me objekt “Blerje vinçi”, ka kualifikuar në mënyrë të gabuar operatorin ekonomik “.....” shpk në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- Në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën me Urdhër prokurimi 04, datë 26.02.2016 me objekt “Blerje gjeneratori dhe aksesore plotësues” ka skualifikuar në mënyrë të padrejtë operatorin ekonomik “.....” shpk dhe ka kualifikuar pa të drejtë operatorin ekonomik “.....” shpk duke shkaktuar një dëm ekonomik prej 732,420 lekë për portin dhe buxhetin e shtetit, në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe Udhëzimin Nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Në cilësinë e anëtarit të KVO, për procedurën me Urdhër Prokurimi Nr. 51, datë 23.05.2015 me objekt “Shtrimi i pjesës së mbetur të sipërfaqes së portit, faza 1”, ka kualifikuar në mënyrë të gabuar operatorin ekonomik “.....” shpk në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar neni 53 pika 4 si dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

4. Znj. E Ç me detyrë përgjegjëse administrate, sepse:

- Në cilësinë e anëtarit të KVO, për procedurën me objekt: “Shtrimi i pjesës së mbetur të sipërfaqes së portit, faza 1”, dhe “Blerje uniforma për sektorin e sigurisë dhe të zjarrfikëses të Portit Shëngjin” ka kualifikuar në mënyrë të gabuar operatorin ekonomik “.....” shpk dhe “.....” shpk në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar Kreu V, Pika e VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

5. Zoti F.K me detyrë përgjegjëse i Degës teknik, sepse:

- Në cilësinë e anëtarit të KVO, për procedurat e prokurimit me objekt: “Blerje uniforma për sektorin e sigurisë dhe të zjarrfikëses të Portit Shëngjin”, dhe “Rilevim topografik e

batimetri e basenit të Portit Shëngjin” ka kualifikuar në mënyrë të gabuar operatorin ekonomik “.....” shpk dhe “.....” shpk në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar Kreu V, Pika e VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

6. Znj. M.M me detyrë Juriste, sepse:

- Në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për procedurën me Urdhër prokurimi 04, datë 26.02.2016 me objekt “Blerje gjeneratori dhe aksesorë plotësues”, nuk ka justifikuar përzgjedhjen e procedurës së përdorur dhe nuk ka argumentuar përzgjedhjen e operatorëve ekonomik të ftuar në kundërshtim me nenin 33, pika 2, dhe nenin 39, pika 4 të VKM 914 datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- Në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për procedurën me Urdhër prokurimi nr. 15, datë 06.06.2016 me objekt “Blerje vinçi”, nuk ka përcaktuar në mënyrë të saktë fondin limit në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

7. Z. L.GJ me detyrë Përgjegjës i degës së ngarkim shkarkimit, sepse:

- Në cilësinë e anëtarit të KVO për blerjet e vogla për periudhën 24.10.2014- 2016, nuk ka kryer asnjë analizë për përcaktimin e fondit limit, nuk ka hartuar procesverbal të marrjes në dorëzim për mallrat e prokuruar, për mos vendosje të specifikimeve teknike në tenderin “Ndërtim i faqes së internetit”, për kryerje fiktive të tenderit “Tavolinë karrige zyre”, për copëzim fondi për dy procedurat me urdhër prokurimi nr. 15 datë 21.05.2015 dhe nr. 14 datë 20.05.2015. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2 datë 28.03.2013 dhe Udhëzimin Nr. 3 datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” si dhe me VKM Nr. 914 datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- Në cilësinë e anëtarit të KVO, për procedurën me Urdhër prokurimi nr. 15, datë 06.06.2016 me objekt “Blerje vinçi”, ka kualifikuar në mënyrë të gabuar operatorin ekonomik dhe “.....” shpk në kundërshtim me VKM Nr. 914 datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- Në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën me Urdhër prokurimi 04, datë 26.02.2016 me objekt “Blerje gjeneratori dhe aksesorë plotësues” ka skualifikuar në mënyrë të padrejtë operatorin ekonomik dhe “.....” shpk dhe ka kualifikuar pa të drejtë operatorin ekonomik dhe “.....” shpk duke shkaktuar një dëm ekonomik prej 732,420 lekë për portin dhe buxhetin e shtetit, në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe Udhëzimin Nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

8. Z. F. GJ me detyrë Punonjës i emergjencës civile, sepse:

- Në cilësinë e anëtarit të KVO për blerjet e vogla për periudhën 2015, nuk ka kryer asnjë analizë për përcaktimin e fondit limit, nuk ka hartuar procesverbal të marrjes në dorëzim për mallrat e prokuruar, për mos vendosje të specifikimeve teknike në tenderin “Ndërtim i faqes së internetit”, për kryerje fiktive të tenderit “Tavolinë karrige zyre”, për copëzim fondi për dy procedurat me urdhër prokurimi nr. 15 datë 21.05.2015 dhe nr. 14 datë

20.05.2015. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2 datë 28.03.2013 dhe Udhëzimin Nr. 3 datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” si dhe me VKM Nr. 914 datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Shënim:

Gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin e Auditimit janë konstatuar përgjegjësi për ish-Nëpunësit Zoti B.M, Zoti A.D, Zoti F.M, për të cilët do të rekomandonim masë disiplinore “*Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna*”, por meqenëse këta persona janë larguar nga detyra në shoqërinë “Porti Detar” SH.A Shëngjin, masat disiplinore konsiderohen të ezauruara.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R